

Zyra qëndrore / Sekretariati i Grupit të Përhershëm të Punës për Zhvillimin Rural Rajonal në Evropën Juglindore (SWG) – Shkup

Kërkesë për Aplikime për financim të trajnimeve profesionale

Data e hapjes: 28 Shtator 2022

Data e mbylljes së aplikimeve: Vazhdon deri më 31 Marsh 2023, ora 16:00 CET

Vlerësimi: Në baza mujore duke filluar nga 28 Shtator 2022 deri më 31 Mars 2023

Subjekti: Kërkesa për Aplikime (RFA) Numri: SWG 2022-001 Trajnim Profesional

Të nderuar aplikantë të mundshëm,

Grupi i Përhershëm i Punës për Zhvillimin Rural Rajonal (SWG) po kërkon aplikime nga aplikantë të kualifikuar në shtetet/territoret e Ballkanit Perëndimor si Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kosovë*, Maqedoninë e Veriut, Malin e Zi dhe Serbi për të aplikuar për kosto financimi për trajnimin profesional në turizëm, bujqësi dhe sektorë të tjerë ndërsektorial si Zhvillimi i Biznesit dhe TIK (ICT), të identifikuar si të rëndësishëm për diversifikimin ekonomik në zonat rurale.

RFA përbëhet nga seksionet kryesore të mëposhtme:

- 1. Përshkrimi i projektit**
- 2. Aplikantët e pranueshëm**
- 3. Veprihtaritë ilustruese që do të financohen sipas kësaj RFA**
- 4. Informacion mbi Administrimin e Mbeshtetjes**
- 5. Kërkesat për dorëzim**
- 6. Informacioni i shqyrtimit të aplikimit**

Në varësi të disponueshmërisë së fondeve, SWG synon të financojë koston për certifikatën e marrë për trajnimin profesional në turizëm, bujqësi dhe sektorë të tjerë ndërsektorial si Zhvillimi i Biznesit dhe TIK (ICT), të identifikuar si të rëndësishëm për diversifikimin ekonomik në zonat rurale, për trajnimin që do të merret ndërmjet 28 Shtator 2022 dhe përfundon më 30 Qershor 2024.

Kjo RFA është një proces aplikimi me dy faza. Në fazën e parë, aplikantëve u kërkohet të paraqesin një Aplikim për financimin e trajnimit profesional në formatin e bashkangjitur, i cili do të shqyrtohet nga Komiteti i Vlerësimit të SWG-së. Aplikantët do të njoftohen nëse aplikimi i tyre për trajnim kualifikohet për rimbursim. Në fazën e dytë, aplikanti do t'i dërgojë SWG-së certifikatën e marrë, sipas së cilës SWG do t'i rimburojë aplikantit financimin deri në 300 EUR bruto duke përfshirë të gjitha taksat përkatëse të koston së trajnimit. Mundësitë e financimit do t'u jepen aplikantëve reagues, aplikimet e të cilëve plotësojnë më së miri kërkesat e kësaj RFA, mbi bazën "i pari vjen i pari përfiton". SWG kërkon që Aplikimi për financimin e trajnimit profesional të dorëzohet në mënyrë elektronike (me e-mail) në Sekretariatit e SWG në swgsecretariat@swg-seerural.org duke filluar nga 28 Shtatori 2022 deri më 31 Marsh 2023.

* Ky përcaktim është pa paragjykim ndaj qëndrimeve mbi statusin dhe është në përputhje me UNSCR 1244/1999 dhe Opinionin e ICJ-së për shpalljen e pavarësisë së Kosovës.

SWG rezervon të drejtën të financojë ndonjë ose asnjë nga aplikimet e dorëzuara. Hapja e kësaj RFA nuk përbën një zotim shpërblymi nga ana e SWG, dhe as nuk e detyron SWG të paguajë për çdo kosto të shkaktuar në përgatitjen dhe dorëzimin e një aplikimi. Gjithashtu, SWG rezervon të drejtën të refuzojë një ose të gjitha aplikimet e pranuar. Të gjitha shpenzimet e përgatitjes dhe dorëzimit janë nën shpenzimet e vetë aplikantit.

1. PERSHKRIMI I PROJEKTIT

Grupi i Përhershëm i Punës për Zhvillimin Rural Rajonal (SWG), si një platformë për rrjetëzim dhe bashkëpunim rajonal, është themeluar gjatë Forumit të Politikave Bujqësore 2005 ("Mundësitë e Zhvillimit Rural për Bashkëpunim në EJL") të mbajtur në Maqedoninë e Veriut dhe Serbi në Qershor 2005. Me Marrëveshjen Ndërkombëtare në Mars 2009, SWG është regjistruar si Organizatë Ndërqeveritare Ndërkombëtare, me organin e saj menaxhues dhe koordinues – Zyrën Qëndrore/Sekretariatit e SWG me seli në Shkup, Maqedonia e Veriut. Më 7 Shtator 2009, në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut është miratuar Ligji për ratifikimin e Marrëveshjes SWG.

Kuadri kryesor strategjik i SWG-së përbëhet nga elementët e mëposhtëm:

Vizioni SWG është të promovojë bujqësi inovative dhe të qëndrueshme dhe zhvillimin rural përmes bashkëpunimit rajonal, për të përmirësuar jetesën rurale në vendet e EJL.

Misioni - rritja e bashkëpunimit horizontal ndërmjet vendeve dhe territoreve përkatëse të Evropës Juglindore, duke koordinuar iniciativat rajonale në lidhje me bujqësinë dhe zhvillimin rural dhe duke mbështetur procesin e zhvillimit social dhe ekonomik të zonave rurale në rajonin e EJL.

Objektivi i përgjithshëm i SWG është të lehtësojë bashkëpunimin e ngushtë ndërmjet Ministrive të Bujqësisë dhe palëve të tjera të interesuara në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural dhe të mbështesë integrimin në BE të EJL.

SWG ka katër objektiva specifike, në të cilat organizata e ka fokusuar punën e saj:

- Të përmirësojë mirëkuptimin e përbashkët mbi politikat e bujqësisë dhe zhvillimit rural;
- Të ndihmojë në përmirësimin e strukturave dhe sistemeve zbatuese për bujqësinë dhe zhvillimin rural, me theks të veçantë në bashkëpunimin ndërkufitar;
- Të përmirësojë të kuptuarit dhe përdorimin e mjeteve të zbatimit për bujqësinë dhe zhvillimin rural;
- Të identifikojë dhe shkëmbejë informacionin dhe zbatimin e praktikave të mira në bujqësi dhe zhvillim rural për të zgjeruar axhendën rurale.

Në nëntor 2021, Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik i dha SWG një projekt 38-mujor me titull "Promovimi i diversifikimit ekonomik në zonat rurale të Evropës Juglindore (SEDRA II) në EJL - Ngritja e kapaciteteve të zinxhirit të vlerës në bujqësi dhe turizmin rural për të promovuar mundësitë e punësimit rural". Projekti zbatohet sipas një marrëveshjeje ndërmjet SWG dhe Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit GmbH (GIZ) për vendet/territoret e Ballkanit Perëndimor të Shqipërisë, Bosnjë dhe Hercegovinës, Maqedonisë së Veriut, Malit të Zi, Serbisë dhe Kosovës*.

Projekti synon të kontribuojë në zhvillimin e balancuar socio-ekonomik të zonave rurale në Ballkanin Perëndimor, përmes bashkëpunimit efikas rajonal dhe fuqizimit të kapaciteteve rajonale për diversifikimin dhe punësimin ekonomik rural. Qëllimi i përgjithshëm i projektit është të stimulojë konkurrencën dhe punësimin në rajon përmes forcimit të kapaciteteve dhe promovimit të sipërmarrjes. Kjo përfundimisht do të rrisë atraksionin e zonave, do të

* Ky përcaktim është pa paragjykim ndaj qëndrimeve mbi statusin dhe është në përputhje me UNSCR 1244/1999 dhe Opinionin e ICJ-së për shpalljen e pavarësisë së Kosovës.

përmirësojë aksesin në treg, duke inkurajuar të rinjtë dhe gratë që të përfshihen më shumë dhe të kontribuojnë në reduktimin e emigracionit.

Objektivi i projektit është të rrisë diversifikimin ekonomik duke lehtësuar masat e rritjes së kapaciteteve në sektorin e turizmit me një potencial të rritjes së mundësive fitimprurëse të punësimit. Fokusi i projektit është në forcimin e përfshirjes ekonomike të popullsisë rurale dhe të marginalizuar, mbështetjen e sektorit formal/joformal rural, nxitjen e praktikave të qëndrueshme të menaxhimit të burimeve natyrore, si dhe promovimin e sipërmarrjeve të grave dhe të rinjve në zonat rurale.

2. APLIKANTET E PRANUESHEM

Individë të punësuar dhe të papunë në sektorët e turizmit, bujqësisë ose sektorë të ngjashëm të një nga 6 vendet/territoret e Ballkanit Perëndimor Shqipërisë, Bosnjë dhe Hercegovinës, Maqedonisë së Veriut, Malit të Zi, Serbisë dhe Kosovës* të cilët janë të gatshëm të marrin aftësi të reja për punësim në turizëm, bujqësi dhe sektorë të tjerë ndërsektorial si Zhvillimi i Biznesit dhe TIK (ICT), të identifikuar si të rëndësishëm për diversifikimin ekonomik, në bashkitë rurale.

Bashkia përkufizohet si rurale:

- nëse dendësia e popullsisë është nën 150 banorë për km² OSE
- nëse popullsia e tij nuk është më shumë se 10,000 banorë OSE
- ndodhen 600 m mbi nivelin e detit.

Ju lutemi shikoni listën e bashkive të pranueshme në Aneksin 3.

SWG inkurajon **Qendrat e Formimit Profesional dhe Bizneset** që ta ndajnë këtë njoftim me studentët dhe punonjësit e tyre të ardhshëm, me respekt.

Si mëposhtë do të kenë një avantazh në marrjen e mbështetjes kundrejt aplikantëve të tjerë:

- Të rinjtë (nën ose të barabartë me 40 vjeç)
- Gratë
- Personat me aftësi të kufizuara
- Të rikthyerit – kane qëndruan në Gjermani ose në një shtet tjetër për më shumë se 3 muaj pas vitit 2001

3. AKTIVITETE ILUSTRUESE QE DO TE FINANCOHEN NEN KETE RFA

Trajnim profesional, trajnimi në punë, stazhi, mbështetje start-up, udhëtime studimore të akredituara nga një institucion shtetëror i autorizuar si trajnim profesional në sektorët e turizmit, bujqësisë dhe sektorëve të tjerë të identifikuar si të rëndësishëm për diversifikimin e ekonomisë vendore në zonat rurale respektive ndërkuftare. Trajnimi profesional duhet të kryhet për të gjetur punësim të ri ose shtesë vendas në turizëm, bujqësi dhe sektorë të tjerë ose për të rritur zhvillimin e biznesit të MSME-ve ku ata janë të punësuar.

Kurse trajnimi ilustruese:

- Trajnim në prodhimin, përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore
- Profesionet e certifikuar turistike (guida, shefa kuzhine, kamerierë, somelierë, etj.)
- Fillimi i një biznesi
- Menaxhimi i Biznesit

* Ky përcaktim është pa paragjykim ndaj qëndrimeve mbi statusin dhe është në përputhje me UNSCR 1244/1999 dhe Opinionin e ICJ-së për shpalljen e pavarësisë së Kosovës.

- Menaxhimi i Financave
- ICT, Marketing Dixhital dhe të ngjashme
- Zhvillimi i planit të biznesit
- Të tjera

4. INFORMACION ADMINISTRIMIT TE MBESHTETJES

- Percaktimi i vendit:** Vendi i percaktimit është 6 vendet/territoret e Ballkanit Perëndimor.
- Afati kohor:** Aplikanti duhet të marrë një certifikatë në afatin kohor nga 28 Shtator 2022 – 30 Qershor 2024.
- Gjuha e komunikimit:** Gjuha e komunikimit me SWG është anglishtja dhe gjuha përkatëse e shtetit/territorit.
- Gjuha e trajnimit:** Gjuha e kursit të trajnimit mund të jetë në një nga gjuhët lokale.
- Maksimumi i shumes së rimbursuar:** SWG do të rimbursojë deri në 300 EUR bruto. TVSH-ja nuk është e pranueshme dhe për këtë arsye ajo nuk do të rimbursohet, por do të zbritet nga Fatura dhe do të konsiderohet si bashkëfinancim i pjesëmarrësit. 300 euro bruto përfshin gjithashtu të gjitha taksat, të kërkuara për t'u paguar nga legjislacioni kombëtar në vendin e rezidencës.
- Formati i Aplikimit:** Të gjitha aplikimet duhet të dorëzohen në formatin e dhënë. Aplikimet e shkruara në një format tjetër nuk do të merren parasysh. (shih Aneksin 1 dhe Aneksin 1.a).
- Disbursimi i pagesës:** Fondet do të rimbursohen me transfertë bankare në llogarinë bankare të marrësit nga SWG.
- TVSH:** TVSH-ja është një kosto e papranueshme, kështu që SWG NUK do ta rimbursojë TVSH-në.
- Gjuha e aplikimit:** Të gjitha dokumentet e aplikimit mund të dorëzohen në anglisht ose në një nga gjuhët lokale të vendit/territorit përkatës.
- Numuri i aplikimeve:** Një aplikant mund të paraqesë vetëm një aplikim.

5. KERKESAT PER DOREZIM

SWG kërkon që Aplikimi për bashkëfinancim të trajnimit profesional të dorëzohet në mënyrë elektronike (me e-mail) në Sekretariatit e SWG në adresën swgsecretariat@swg-seerural.org duke filluar nga data 28 shtator 2022 deri më 31 marsh 2023.

Aplikantët duhet të dorëzojnë dokumentet e mëposhtme:

- **ANEKS 1. APLIKIM PER TRAJNIM PROFESIONAL kopje e firmosur dhe skanuar ne PDF**
- **ANEKS 1.a ne MS Excel**
- **CV**

- **Dokument që vërteton Akreditimin e programit të trajnimit i marrë nga Institucioni i Trajnimit ose nga faqja e tyre e internetit.**

Ju lutemi shënoni “Emri juaj - Aplikimi për Trajnim Profesional” në fushën Subject të e-mail-it tuaj.

SWG do të mbajë të gjitha materialet dhe dokumentet e dorëzuara nga aplikantët. Ai nuk do ta përdorë këtë informacion për qëllime të tjera përveç shqyrtimit të aplikimit dhe nuk do ta ndajë atë me persona apo institucione të tjera.

Pas procesit të vlerësimit, vendimi do t'u komunikohet aplikantëve përmes postës elektronike me e-mail.

6. INFORMACION SHQYRTIMI I APLIKIMIT

Aplikimet duhet të dërgohen në mënyrë të vazhdueshme duke filluar nga 28 Shtatori 2022 dhe duke përfunduar më 31 Marsh 2023.

Komisioni vlerësues i SWG do të shqyrtojë aplikimet dhe do t'i informojë aplikantët për statusin e aplikimit të tyre jo më vonë se 30 ditë pas dorëzimit të tyre.

Pagesa: Rimbursimi deri në 300 EUR pa TVSH të shpenzimeve të lejuara të mbështetura nga:

1. Kopje e dokumentit të identitetit
2. Kopje e Faturës nga institucioni lëshues i Certifikatës
3. Kopja e Certifikatës së marrë
4. Kopje e dokumentit të Vërtetimit të pagesës
5. Kërkesë për rimbursim (Aneks 2)

Pagesa do të bëhet 30 ditë pas miratimit të kërkesës për pagesë dhe dokumenteve mbështetëse.